



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.26, datë 1/12/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI  
UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT  
“KOXHERRI” SH.P.K, ME VENDNDODHJE, NJ.A MARTANESH,  
BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë “Koxherri” sh.p.k, “Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për qëllime industriale”, me vendndodhje, objekti “Maja e Lugut”, Njësia Administrative Martanesh, Bashkia Bulqizw, Qarku Dibër.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së burimit ujor (KRGJSH)

-X=520018.1; Y=4587388.6; Z=970 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: Q=2.2 l/sek

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

-X=519984.3; Y=4587406.8; Z=980 m.m.n.d

Sasia e ujit që shkarkohet: Q=2 l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI I KBU MAT**

**GJERGJ PRENDI**

